



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
KËSHILLI I BASHKISË
KORÇË

VENDIM
Nr. 117 Datë 03.12.2010

PER

Miratimin e "Fondit të investimit për zbatimin e PBEE në Qendrën Rezidenciale të Zhvillimit"

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, i mbledhur në datën e sotme, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Financës dhe DPUHPI "Për miratimin e fondit të investimit për zbatimin e PBEE në Qendrën Rezidenciale të Zhvillimit", bazuar në ligjin nr. 8652 dt. 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" neni 32 pika k dhe dh , ligjin nr. 10190 dt. 26.11.2009 «Për buxhetin e vitit 2010», Udhëzimin nr.1 dt.21.01.2010 M.F «Për zbatimin e buxhetit të vitit 2010», V.K.B nr. 20 dt. 25.03.2010 «Mbi miratimin e buxhetit të Bashkisë dhe institucioneve të vartësisë për vitin 2010», Ligji nr. 9936 dt. 26.06.2008 «Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë», dhe mbështetur në kompetencat që ka si dhe mbas diskutimit të anëtarëve:

VENDOSI

1. Të miratoje fondin prej 238,000 lekësh për termoizolimimin e mureve të jashtme, vendosjen e llampave me eficiencë energjie, vendosjen e dritareve me dopio xham si dhe termoizolimimin e çatisë me kulm, i cili do t'i kalojë Qendrës së Eficiencës së Energjisë Tiranë (QEE).
2. Ky fond do të përballohet nga fondi i shpenzimeve operative të Bashkisë (kësti i kredisë) me këtë strukturë buxhetore:

PAKESOHET	00	01110 05	Art.6020000 -238,000 lekë
SHTOHET	00	01110 05	Art.6040000 +238,000 lekë

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës. Drejtoria Juridike, Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Hartimit të Projekteve në Infrastrukturë si dhe QEE Tiranë.

4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Kryetari

GJERGJI PENDAVINJI